



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRI E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHPLLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:  
SPECIALIST I WEB DHE MEDIA  
DREJTORIA E MARKETINGUT**

**1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:**

**Emërtesa e pozicionit:** Specialist i Drejtorisë së Marketingut (web dhe media)

**Klasa e pagës:** IV-1

**Drejtoria:** Drejtoria e Marketingut

**Raporton te:** Drejtori Marketingut

**2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT:** Specialisti i Drejtorisë së Marketing (Web dhe Media) përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë së Marketing për monitorimin dhe mirëmbajtjen, si dhe cilësinë e publikimeve të lajmeve në faqen e internetit të Agjencisë.

**3. DETYRAT KRYESORE:**

- Monitorim i medias mbi zhvillimet e fundit ekonomike në vend, rajon e më gjerë dhe publikon lajmet në faqen e internetit të Agjencisë;
- Mirëmbajtjen e bazës së të dhënave (database) të IHD, NVM, Marketing dhe Medias, si dhe përditësimin e tyre me kontaktet e reja;
- Organizimin e aktiviteteve ku Agjencia është organizatore ose palë pjesëmarrëse;
- Përzgjedh formatin e aktivitetit dhe përgatit agjendën;
- Kontakton me mediat dhe përgatit materialin për njoftimin për shtyp;
- Përgatit materiale promocionale lidhur me temën specifike të aktivitetit;
- Monitoron adresën postare info@aida.gov.al dhe përgjigjet për monitorimin paraprak dhe konstataues të përmbajtjes së çdo e-maili që vjen në këtë adresë;
- Bashkëpunon me skuadrën e PR të Ministrisë përgjegjëse për ekonominë nga varet agjencia;
- Organizon vizitat për personat e rëndësishëm;
- Bashkëpunon me të gjitha Drejtoritë e Agjencisë, për të përcaktuar aktivitetet në të cilat do të merret pjesë dhe ndihmon në përgatitjet e raporteve përkatëse, në publikimin e historive të suksesit të investitorëve, kompanive shqiptare dhe dëshmitë e investitorëve (testimonials).
- Është pikë kontakti për komunikimin ndërkombëtar, ndërinstitucional dhe trupet diplomatike;
- Sigurohet për përditësimin e faqes zyrtare të internetit të Agjencisë;
- Koordinon dhe siguron që materialet e marketingut të jenë të përditësuara dhe kujdeset për botimin apo vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë;
- Koordinon punën lidhur me përgatitjet për misionet që vijnë, pikat e kontaktit për të dërguar të dhëna periodike dhe materialet për ministritë, ambasadave dhe stakeholders, si dhe u jep përgjigje ministrive për të dhëna që kërkohen nga Agjencia;

- Promovon Shqipërinë dhe rajonin në komunitetin e investitorëve dhe prezanton mundësitë për investim pranë investitorëve potenciale apo ekzistues;
- Përgjigjet për organizimin e aktiviteteve, PR dhe reklamën, duke përgatitur fushata të përmirësimit të imazhit, duke menaxhuar marrëdhëniet me median dhe duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet medias (përfshirë faqen e internetit dhe mediat sociale);

#### **4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI**

**Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

#### **5. KËRKESAT E POSAÇME:**

**Arsimi:** Bachelor në shkenca shoqërore, politike, komunikimi, ekonomike, kompjuterike, informatikë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

**Përvoja:** Të paktën 2 (dy) vite eksperiencë pune.

**Tjetër:** Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

#### **6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
  - e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
  - g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(10.03.2025 afati i fundit i aplikimit)**.

## **7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT**

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

*a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.*

*b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;*

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

## **8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.

